



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 14032 prot.

Lezhë, më: 07-07 2026

SHPALLJE

PËR SIPËRFAQET PYJORE QË DUHET TË RIPYLLËZOHEN NË KUADËR TË SEKUESTRIMIT TË KARBONIT.

Baza ligjore: Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 57/2020 datë 30.4.2020, pika 3 e nenit 33 parashikon; Ripyllëzimet kryhen në sipërfaqet pyjore të dëmtuara nga shkaqe të ndryshme dhe ku nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrore, në sipërfaqet ku filizëria e instaluar është djegur dhe dëmtuar dhe nuk garantohet zhvillimi i grumbullit të ri, si dhe në sipërfaqet ose brezat pyjorë që trajtohen me pyllëzime artificiale dhe prerje rrah.

Plani i Mbarështimit i ekonomisë pyjore ka përcaktuar parcelat pyjore në të cilat ndër vite kanë patur humbje të mbulesës bimore pyjore për arsye të ndryshme që lidhen me prerjet e paligjshme apo djegiet nga zjarret. Lidhur me këtë situatë të trashëguar aktualisht kemi sipërfaqe pyjore të studiuara sipas Planit të Mbarështimit për të cilat është caktuar ndërhyrja me pyllëzime artificiale për të kryer instalimin e pyllit, frenimin e erozionit, krijimin e biomasës drusore e cila përveç nevojave të komunitetit për lëndë drusore do të realizojë efekte të rëndësishme mjedisore që lidhen me:

1. Përmirësimi i cilësisë së ajrit.
2. Përmirësimi i regjimit të mikroklimës.
3. Pasurimi i biodiversitetit.
4. Mbrojtja e tokës pyjore nga erozioni dhe rrëshqitjet.
5. Frenimi i ujrave sipërfaqësore duke ndikuar në zvogëlimin e përmytjeve.
6. Përmirësimi dhe pasurimi i ujrave nëntokësore.
7. Sipërfaqe të gjelbërta për komunitetin.
8. Mundësi punësimi lokal në mbjellje apo shërbime kulturale.

Në kuadër të shfaqjes së interesit nga shoqëri të ndryshme, për marrjen në përdorim të këtyre sipërfaqeve pyjore për financimin e pyllëzimit si një detyrim që kanë shoqëritë e ndryshme për kompensimin e emetimeve të karbonit që nuk mund ti zvogëlojnë vetë, Bashkia Lezhë ofrohet për vënien në dispozicion të këtyre sipërfaqeve për tu pyllëzuar, mirëmbajtur dhe monitoruar me fondet e kompanisë me synim krijim e pyllit në parcelat pyjore të shpyllëzuara e të degraduara.

Parcelat pyjore të planifikuara për ndërhyrje me pyllëzime jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr	Bashkia	Kodi Kadastral	Ekonomia Pyjore	Ngastra/nëngastra	Sipërfaqja ha	Gjendja sipas PM	Shënime
1	Lezhë	LE41 00 010b	Zadrimë	10b	2.63	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
2	Lezhë	LE41 00 011b	Zadrimë	11b	4.6	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
3	Lezhë	LE41 00 013b	Zadrimë	13b	20.21	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
4	Lezhë	LE41 00 001b	Zadrimë	1b	6.76	Shkurre të rralla	Propozuar për pyllëzim më Akacia
5	Lezhë	LE41 00 003c	Zadrimë	3c	8.44	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
6	Lezhë	LE41 00 071c	Zadrimë	71c	14.38	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
7	Lezhë	LE41 00 073c	Zadrimë	73c	24	Sipërfaqe me bimësi	Propozuar për pyllëzim më Akacia
					Totali 81.02		

Shoqëritë e interesuara duhet që të dorëzojnë letër interesi për shpalljen dhe dokumentacionin si mëposhtë vijon:

1. Nipti i Shoqërisë.
2. Liçensë për kryerjen e punimeve të pyllëzimit dhe shërbimeve kulturore ose marrëveshje më shoqëri që ka liçensën përkatëse dhe ka kryer punime të ngjashme.
3. Projekti teknik i zbatimit për pyllëzimin i hartuar nga Inxhinier Pyjesh i liçensuar.
4. Plan biznesin.
5. Hartat e gjeoreferuara për parcelat ku do kryhet pyllëzimi.

Për informacione të mëtejshme na kontaktoni në adresën të cilën e gjeni në Web-in www.lezha.gov.al

Afati i dorëzimit të kërkesave për shprehje interesi do të jetë 20 ditë pune nga data e publikimit të shpalljes.

KRYETARI
Pjerin NDREU

